

Gjykata Supreme e Kosovës në panelin e përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar Z. Patrice de Charette si kryetar paneli, Z. Antti Ruotsalainen dhe Z. Martti Harsia, si anëtarë, në praninë e procesmbajtëses Allten Murseli, në rastin penal kundër të pandehurit Sava Matić nga Rahoveci, i akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile sipas nenit 142 paragrafi 1 i Ligjit Penal të Jugosllavisë duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren dhe avokatit mbrojtës të të akuzuarit Z. Ljubomir Pantovic kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C. Nr. 48/2000 të datës 29.01.2001, në seancën e mbajtur me 13.06.2001 mori këtë

AKTVENDIM

Aprovohet ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, prishet aktgjykimi C. Nr. 48/2000 i datës 29.01.2001 i Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallë së parë për rigjykim.

Ankesa e avokatit mbrojtës Ljubomir Pantovic refuzohet si e pabazuar.

Arsyetimi

Prokurori publik i qarkut në Prizren në aktakuzën e tij PP.nr. 310/99 të datës 1.09.2000 kishte akuzuar Sava Matic për krime lufte kundër popullatës civile sepse Matic gjatë konfliktit të armatosur në qershor 1998 në Rahovec dhe gjatë kohës së luftës 23.03 – 12.06.1999 në Kosovë, në territoret e komunës së Rahovecit dhe fshatrat Krushë e Madhe dhe Potoqan i Ulët, kishte dhënë urdhra për sulmin kundër popullatës së pambrojtur civile, kishte shkaktuar vuajtje dhe ishte sjellur në mënyrë jo-humane duke aplikuar frikësimin, terrorin, kidnapimet, veprat e kundërligjshme të mbylljes së njerëzve nëpër burgje apo dërgimin e tyre nëpër kampe për punë të detyruar, si dhe shkatërrimin dhe plaçkitjen e pronave në masë të madhe, kundërligjshëm, dhe të paarsyeshme për nevojat e ushtrisë, djegien e shtëpive, plaçkitjen e pronës së luajtshme të popullatës Shqiptare dhe shkeljen e rregullave të të drejtave ndërkombëtare. Duke qenë anëtar i forcave paramilitare në Rahovec ai ekzekutoi urdhrat e dhëna nga të tjerët për kryerjen e krimeve të sipër përmendura duke qenë i veshur me uniformë policore kamuflimi dhe duke bartur armë automatike. Ai mori pjesë me 26.03.1999 në ekzekutimin e 42 personave mes tyre O ■■■■■, S ■■■■■, B ■■■■■ H ■■■■■, R ■■■■■ R ■■■■■ A ■■■■■ H ■■■■■ dhe F ■■■■■ H ■■■■■ nga Krusha e Madhe, si dhe rrahjen dhe keqtrajtimin e Xh ■■■■■ A ■■■■■ Q ■■■■■ S ■■■■■ H ■■■■■ H ■■■■■, H ■■■■■ A ■■■■■, I ■■■■■ Z ■■■■■ dhe S ■■■■■ Z ■■■■■ dhe plaçkitjen e Potoqanit të Ulët.

Gjykata e Qarkut në Prizren në aktgjykimin e tij numër C. Nr. 48/2000 i datës 29.01.2001, theksoi se prokurori publik nuk kishte mundur të prezantoj prova të mjaftueshme kundër të akuzuarit për të vërtetuar se ai ishte fajtor për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 paragrafi 1 i Ligjit Penal të Jugosllavisë.

Përkundër kësaj gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i pandehuri gjatë bombardimeve të NATO-s me 23.04.1999 në Rahovec, në vreshtën e A. H. [REDAKTUAR] dhe djemve të tij H. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] dhe Sh. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR], bashkë me S. [REDAKTUAR] G. [REDAKTUAR] dhe dy Rom të gjithë të veshur në uniforma ushtarake dhe duke mbajtur armë, kishin takuar palët e dëmtuara, H. [REDAKTUAR] të cilët po krasitnin vreshtën e tyre. Matici dhe partnerët e tij filluan të keqtrajtonin H. [REDAKTUAR] dhe u lidhën duart me tela në shtyllat e hardhive të rrushit. Për shkak të rrahjeve H. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] i ra të fikët dhe palët tjera të dëmtuara fituan të nxira nëpër trup. Duke vepruar në bashkëpunim Matici u bë fajtor për kryerjen e veprës penale të lëndimit të lehtë sipas nenit 39 paragrafi 2 i Ligjit Penal të Kosovës dhe u dënua me dy (2) vite burgim në të cilën është llogaritur edhe periudha e kaluar në paraburgim që nga 27.12.1999. Sipas nenit 351 paragrafi 1 pika 5 e LPP, Gjykata e Qarkut vendosi të konfiskoi pushkën automatike me numrin serik E 12266 dhe 100 plumba. I pandehuri obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale me shumën paushall prej 100 DM.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur ankesë nga prokurori publik i qarkut për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës Supreme që të prishë aktgjykimin e atakuar dhe të kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren është parashtruar ankesë dhe nga avokati mbrojtës i të akuzuarit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe lartësisë së dënimit duke i propozuar Gjykatës Supreme që të ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ti shqiptoj të akuzuarit dënimin me kusht apo një dënim theksueshëm më të lehtë.

Prokurori Publik i Kosovës përmes mocionit të tij PPA nr. 96/2000 të datës 09.05.2001 propozoi që ankesa e Prokurorit publik të qarkut në Prizren të aprovohet dhe aktgjykimi i i Gjykatës së Qarkut në Prizren të prishet gjersa ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës të refuzohet si e pabazuar.

Në seancën e panelit të mbajtur në pajtim me nenin 371 paragrafi 1 i LPP, Prokurori Publik i Kosovës nuk ishte prezent ndonëse ishte ftuar me rregull, në prezencën e avokatit mbrojtës Ljubomir Pantovic, i cili pas disa sqarimeve mbeti pranë ankesës së tij, Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e lëndës dhe ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar sipas nenit 376 paragrafi 1 LPP dhe pas vlerësimit të asaj çka kishte në letrat e ankesës gjeti se:

Ankesa e Prokurorit publik të qarkut në Prizren është e bazuar dhe ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazuar në këtë pikë.

Prokuroria ka bazuar ankesën e tij duke thënë se gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e procedurës penale me një vendim të paqartë dhe konkluzionet

kontradiktore si dhe arsyetimin jo-ekzistues. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal duke dënuar të akuzuarin me dënim për lëndim të lehtë përderisa aktakuza ishte për krime lufte kundër popullatës civile. Të dy krimet kanë elemente të ndryshme për kualifikim. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar. Dëshmitarët okular kanë dëshmuar se Matiçi ishte udhëheqës i një grupi policësh dhe ai kishte dhënë urdhëra për veprime të dhunshme kundër popullatës civile. A ■■■■ Z ■■■■ , S ■■■■ G ■■■■ dhe J ■■■■ D ■■■■ në mënyrë të detajuar ishin dëshmitarë të incidentit me 23.04.1999, kur ishin ndarë nga burrat, gratë dhe fëmijët dhe u ishte thënë të vazhdojnë për Shqipëri, ku meshkujt e rinj ishin mbajtur si pengje dhe grupi prej 23 njerëzish ishte urdhëruar që të shkoj në drejtim të Nagavcit e grupi tjetër i njerëzve ishte urdhëruar të vazhdoj për në Krushën e Madhe. Pas pak ishin dëgjuar të shtënat drejt grupit të njerëzve që shkonin në Nagavc.

Pas vlerësimit Gjykata Supreme gjen se ankesa e Prokurorit publik të qarkut me arsye atakon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe konkluzioneve të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Supreme gjen se gjendja faktike duhet të plotësohet me prezantimin e provave dhe kjo mund të jetë kusht për kompletimin e duhur dhe të ligjshëm në këtë çështje juridike penale.

Andaj, Gjykata Supreme e konsideron të domosdoshme që gjykata e shkallës së parë të bëjë hetime në skenën e krimit të pandehur të masakrës, ti ballafaqoj dëshmitarët me deklaratat kontradiktore, të studioj dhe ekzaminoj elementet dhe detajet e veprës penale në lidhje me aktakuzën dhe identifikimin e njerëzve të cilët siç pandehet humbën jetët e tyre nën rrethanat e përshkruara në aktakuzë. Gjendja faktike mundet gjithashtu të sqarohet dhe të merr në konsiderim se a duhet të dëgjohen si dëshmitarë A ■■■■ H ■■■■ dhe Sh ■■■■ H ■■■■ përkitazi me incidentin e datës 23.04.1999. në rigjykim gjykata do të merr parasysh vërejtjet e sipër përmendura dhe do të merr një aktgjykim të duhur në këtë çështje penale.

Gjykata Supreme gjen se bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit Sava Matiç i cili ka filluar me 27.12.1999, në lidhje me nenin 191 paragrafi 2 pika 1 LPP ende ekzistojnë sepse po të jetë i akuzuari në liri mund të paraqitet rreziku për ikjen e tij. Për më tepër, pasi që është lehtë të lëshohet territori i Kosovës pa formalitete, vazhdimi i paraburgimit si masë e sigurimit të prezencës së të akuzuarit në kuptim të paragrafit 2 pika 1 është një domosdoshmëri në këtë çështje penale dhe për këtë shkak edhe i zhvillimit normal të procedurës penale.

Bazuar në të lartë-përmendurat dhe në pajtim me nenin 385, paragrafi 1 i LPP është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AP Nr. 94/2001 i datës 13.06.2001

Procesmbajtësja
Allten Murseli

Gjykatësi ndërkombëtar
Antti Ruotsalainen

Kryetari i panelit
Patrice de Charette